

WORKSHOP-KODRA E TRIMAVE

DATA: 31.05.2022

ORA: 16:00

VENDI: SHFMU "ZENEL HAJDINI" PRISHTINË

PERMBAJTA:

- 1.Regjistrimi i pjesëmarrësve
- 2.Qëllimi i takimit
- 3.Prezentimi i vizionit
4. Prezentimi i procesit të deritanishëm
- 5.Prezentimi i objektivave
- 6.Diskutim me qytetarët për Planin rregullues dhe problemet që ballafaqohen ata në lagje

PJESËMARRËS NË TAKIM:

1. Përparim Rama, kryetar i Komunës
2. Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës
3. Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik
4. Arbër Sadiki, Drejtor i Urbanizmit
5. Vllaznim Osmani, Kabineti i Kryetarit
6. Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
7. Drejtore të drejtorive të Komunës së Prishtinës
8. Banorët e lagjes "Kodra e Trimave" në Prishtinë

1.REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE:

(Të bashkëlidhura i gjeni listat e nënshkrimeve të banorëve të lagjes)

PROCES VERBALI:

EKSTARKTI I PROCESVERBALIT

Të diskutimit publik me qytetarët e lagjes “Kodra e Trimave” në Prishtinë

Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, iu shprehu mirëseardhje të pranishmëve në këtë diskutim publik. Ai theksoi se jemi në një proces shumë të rëndësishëm për ju dhe për lagjen tuaj. Jemi duke punuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale. Ky proces kërkon angazhim maksimal dhe duhet të jetë gjithëpërfshirës, ky është edhe qëllimi i takimit tonë të sotëm për këtë diskutim publik, që bashkërisht t'i bëjmë planet, e jo si në rastet tjera që planet të bëhen nëpër zyra, pastaj të imponohen te qytetarët. Jemi duke bërë diskutime publike me qytetarët e Prishtinës të të gjitha lagjeve. Sot kemi pasur një takim të tillë edhe me qytetarët e lagjes “Kalabria”. Sot jemi me ju, për të vazhduar më pas me të gjitha lagjet e Prishtinës, në mënyre që së bashku të punojmë në këtë dokument, që quhet Plani zhvillimor komunal, e që është shumë me rëndësi për zhvillimin e qytetit, në aspektin urban, ekonomik e shoqëror. Kryetari do të na bashkëngjitet pak më vonë, andaj ju lutem që sot të jeni të hapur, t'i jepni idetë, shqetësimet e kërkesat tuaja. Bashkë me mua sot është drejtori i Urbanizmit, shefi i Kabinetit të Kryetarit, janë arkitektë të angazhuar me ne, drejtoresha e Planifikimit dhe drejtorë të tjerë. Do të mundohemi me u përgjigjur në pyetjet tuaja. Për ato pyetje për të cilat nuk do të kemi përgjigje, do të marrim shënime dhe do t'ju kthejmë përgjigje më vonë. Kemi filluar me këtë takim, por ky s'është takimi i fundit, është vetëm fillimi i bashkëpunimit tonë.

Florim Krasniqi theksoi se para se të vazhdojmë tutje, desha të ju qartësoj që ky takim do të ndahet në dy pjesë, pjesa e parë është pjesa e prezantimit, që do të bëhet nga drejtorja e Planifikimit, do të vazhdojmë me drejtorin e Urbanizmit, pjesa e dytë pason me një bashkëbisedim, për të vazhdua më pas me pyetje dhe përgjigje, në mënyrë që t'i dëgjojmë nga afër ankesat, kërkesat dhe hallet tuaja.

Mimoza Sylejmani para të pranishmëve bëri prezantimin e saj, inxhinierë e arkitekturës, tani drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit. Ne sot kemi ardhur që bashkërisht t'i ndajmë kërkesat dhe idetë tuaja, që t'i inkorporojmë në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale, që tashmë është një projekt. Jemi në fazën e parë të procesit, jemi duke i trajtuar të gjitha problemet në të gjitha lagjet. Siç tha edhe Florimi më herët, së bashku do ta bëjmë edhe një punëtori, ku i kemi të printuara të gjitha hartat e lagjes suaj, i kemi të ndara në dy pjesë, “Kodra e Trimave 1”, ku kemi Plan rregullues, që është votuar nga Kuvendi i

Komunës më 2015, që ka sipërfaqe prej 340 hektarë; dhe e kemi “Kodra e Trimave 2”, që është në Planin zhvillimor urban, por që nuk ka plan rregullues dhe shtrihet në 245 hektarë. Të dyja bashkë do të trajtohen ashtu siç e ka përmendur edhe kryetari në fushatë që do të rigjenerohet “Kodra e Trimave”. Këtu në ilustrimet mbrapa meje që po i shihni (skica në projektor) është një pjesë e lagjes “Kodra e Trimave”, qysh mundemi me e trajtuar. E di që ka problematika shumë të mëdha, sidomos rreth pronës, dhe që është brenga juaj kryesorja, por bashkërisht do t'i zgjidhim, kështu që ju lutem çkado që keni na thoni sot. Me neve është edhe kryetari i Asociacionit të Arkitektëve, z. Masar Dushi, të cilin e falënderoj që është çdoherë me ne. Pa humbur kohë, fjalën ia jap drejtorit të Urbanizmit, z. Arbër Sadiki.

Arbër Sadiki tha se po përpiqem të them ato çka nuk u thanë, ato që pak a shumë i takojnë drejtorisë të cilën unë e përfaqësoj, Drejtoria e Urbanizmit. Vizionet e zhvillimeve të qyteteve ndërtohen prej vizioneve politike, i ndërton ai i cili e fiton një garë politike, në këtë rast është Përparimi, ai i cili i ka shpalosur disa vizione, se si do të bëhet Prishtina në vitet sa do ta udhëheq. Drejtoria e Planifikimit i

planifikon këto vizione dhe Drejtoria e Urbanizmit i zbaton ato. Ideja pse ne po mundohemi me qenë bashkë gjithkund është se qysh në fazat e para të planifikimit po dëshirojmë me pasur plane të zbatueshme.

Ju e dini se ne lagjen tuaj ka bukur shumë probleme dhe qëllimi është që ne sot të bashkëbisedojmë, të ju dëgjojmë juve, sepse një plan i mirë mund të jetë i mirë vetëm nëse i dëgjojmë mirë shfrytëzuesit e atij plani, që janë njerëzit që jetojnë në atë pjesë. Ne sot do të përpiqemi me marrë sa më shumë informacione nga ju për lagjen tuaj, për t'u kthyer pastaj me propozime, në mënyrë që produkti përfundimtar me qenë një marrëveshje, një kontratë e përbashkët mes neve që planifikojmë dhe juve që keni me i gëzuar cilësitë e atij planifikimi. Këto diskutime janë të parapara edhe në procedurat e

planifikimit, por kjo nuk është arsyeja pse ne jemi këtu. Ne dëshirojmë me i marrë ato të dhëna të cilat neve na duhen jashtëzakonisht shumë, që në të ardhmen me e pasur një plan të mirëfilltë, çfarë edhe po duam me bërë.

Florim Krasniqi u shpreh se po vazhdojmë me diskutimin dhe çfarëdo shqetësimi, ankese apo kërkesë që keni apo pyetje ta thoni këtu. Ne do të përpiqemi të përgjigjemi në çdo pyetje tuaj, pastaj së bashku e kemi pjesën e dytë të takimit, që është “workshop”.

Shaip Hajrizi, banor i lagjes, theksoi se shpesh kam ardhur te ju në zyrë shumë herë edhe asgjë, ka që 4 muaj kurrfarë rregulli. A ka mundësi të bëhet një stacion i autobusëve, vendi është te Stacioni i Trenit, i vjetri, edhe me i hequr kerret prej Stacioneve të Autobusëve edhe inspektorët me punuar më shumë ju rrogat po ua jepni, nuk kanë çka kërkojnë kerret me u ndalur në stacione të autobusëve.

Arbër Sadiki, atë që jemi duke e bërë tani është një plan mobiliteti, që funksionon në tërësi, sepse zgjidhja e vetëm një linje, është zgjidhje vetëm aty për aty, vetëm për një pjesë të lagjes dhe shpesh ka gjeneruar probleme edhe më të mëdha. Këtu e kemi edhe Ilirikun, i cili është më shume i kyçur në pjesën e hartimit të dokumenteve që lidhen me planifikimin e qytetit. Për atë sot ne jemi këtu që me i mbledhur këto shqetësime tuaja, për me i pasur si zgjidhje të integruara në Planin zhvillimor, por zgjidhje tek e tek, vetëm për t'ia bërë qejfin dikujt, ne nuk i shohim si zgjidhje të shëndetshme për vizionin që e kemi për qytetin. E di që shpesh ndoshta edhe është vepruar kështu, prandaj ne e kemi këtë cilësi të cilën e kemi, sepse janë zgjidhur problemet aty për aty, pa u integruar në tërësinë e vetë. Kjo mënyrë si po e mendojmë ne, vizioni ynë merr më shumë kohë, por ne jemi të bindur se kjo është rruga e vetme për të projektuar diçka strategjike edhe për me pasur një cilësi më të mirë të jetës.

Burim Abazi, banor i lagjes, tha se për ta bërë një plan urbanistik këtu në lagjen tonë është shumë lehtë, sepse nuk ka bash asgjë këtu, kështu që duhet me u nisur një plan prej fillimi, e për me u nisur prej fillimit duhet që së pari me u zgjidhur çështja e pronave. Ku jemi me pronësi, në çfarë mënyre duhet me u zgjidhur ky problem. Jemi mbetur ku kemi mbetur, por së pari çështjen e pronësisë edhe planin me e planifikuar prej fillimit.

Arbër Sadiki, theksoi se ne këtu e kemi bërë një analizë të çështjeve pronësore, e kemi përpiluar një hartë e cila i përcakton saktë se ku janë pronat komunale, pronat të cilat i menaxhon AKP-ja, pronat private edhe pronat të cilat i ka Qeveria. Prapë po kthehem te ajo që thash më parë, ideja për me planifikuar mbi bazë reale niset prej trajtimit të pronave, prej tokës, edhe puna e parë që duhet me u qartësuar është kjo, e në rastin e juaj nuk është shumë e lehtë, sepse ju e dini që një masë jo e vogël e tokave janë toka jo private. Ne i kemi studiuar disa shembuj të vendeve tjera, po mundohemi që me

shikuar si mundet me funksionuar për realitetin tone, se si ta bëjmë një partneritet mes njerëzve që e kanë shfrytëzuar atë tokë me vite dhe poseduesit ligjorë të asaj toke. Ne jemi duke u menduar për një pilot-projekt se nuk ka mundësi kjo me u bërë në komplet lagjen përnjëherë, ka me u gjetur një pjesë e

lagjes në të cilën dominojnë më shumë hapësira të cilat janë jo private dhe në atë pjesë me e zhvilluar një projekt, i cili e kthen lagjen prej një lagje me banime individual në një lagje me ndërtesa shumë banesore, që me i kënaqur edhe ata që jetojnë në atë pjesë edhe ata që prej një prone të paligjshme me u kthyer me një pronë të ligjshme, edhe pjesa tjetër me u zhvilluar me partneritetin publiko-privat, që mendon Komuna e Prishtinës me e zhvilluar. Këto janë forma të reja që po zhvillohen në Prishtinë, por që janë praktikë shumë e thjeshtë e që vendet me dekada i zhvillojnë. Çdo gjë që bëhet për herë të parë, sado e thjeshtë të jetë, për ne ka me qenë pak më problematike, por jemi të bindur që ajo është e mundshme. Ne e kemi analizuar shumë, kemi edhe ekspertë që i kemi angazhuar nga jashtë, Roberti është marrë shumë me këtë, ai vjen nga Anglia, e këto praktika ata i kane zbatuar shumë shpesh, edhe ne po mundohemi me i marrë krejt këto praktika të mira, pa ju imponuar juve asgjë, por duke i biseduar me juve, duke shkuar lagje më lagje, sepse secila lagje i ka specifikat e veta. Ne jemi në hulumtim të lagjeve në të cilat mundemi me e implementuar këtë model më së miri. Në momentin që implementohet njëherë, pastaj vazhdojmë me një lloj cikli, ku prej lagjes në lagje zhvillohet në mënyrë të njëjtë. Ne ndryshe nuk kemi mundësi me pasur hapësira publike ne lagjen tuaj pa i hyrë një rigjenerimi të thellë, që në momentin që planifikojmë diçka, p.sh. me e realizuar shumë shpejt dhe shumë lehtë.

Kastriot Jusufi, banor i lagjes, tha se lagjja jonë ka shumë probleme, një prej tyre është rruga që është e bllokuar prej parkimit të veturave vend e pa vend nga bizneset që funksionojnë këtu, ose prej blerësve. Me pëlqeu ideja e drejtorit të Urbanizmit, që këtu të bëhet ndërtim banesor, është shumë lehtë, se pjesa më thellë lagjes është krejt fushë, jo si ne lagjen “B”, por me hapësira të gjelbëruara, me parking të mirë.

Florim Krasniqi theksoi se pyetja juaj ndërlidhet me atë çka veç e tha më herët drejtori.

Arbër Sadiki, desha vetëm një sqarim për atë që thatë që është shumë lehtë me bërë plan këtu se është fushë. Unë nuk kisha me thënë që është lehtë nëse i marrim qasjet e gabueshme, se fushë ka qenë edhe Mati njëjtë, por sot ju e dini si duket.

Xhafer Cakolli falënderoi për mundësinë e këtij bashkëbisedimi nga ana e Komunës. Në vitin 2013 është prezantuar një plan zhvillimor dhe nuk është bërë asgjë. Në lagjen tone mungojnë shkolla, çerdhe, hapësirat e gjelbra etj. Ne jemi të ngufatur prej këtyre ndërtimeve me leje e pa leje, këto janë shqetësime me të cilat ne ballafaqohemi çdo ditë, andaj ne presim që ju të na jepni një pasqyrë më reale për lagjen tonë.

Mimoza Sylejmani e bëri një sqarim, duke thënë se në këtë fazë ne jemi në hartim të projektit, ne sot kemi ardhur me diskutuar me juve për nevojat e shqetësimet të cilat ju i keni, e ne me ju treguar se në çfarë mënyre po duam me e rigjeneruar lagjen tuaj. Ky sot nuk është prezantim, se prezantim është tek kur miratohet në Kuvendin e Komunës dhe inicohet për diskutim publik.

Qerim Shabani, banor i lagjes, tha se unë jetoj në lagjen “Kodra e Trimave” që më shumë se 50 vjet, dhe një prej problemeve më të mëdha që kemi shumica këtu, është çështja e pronësisë, të na mundësohet legalizimi i pronës; e dyta, ka qenë një projekt për nxehjen qendrore që e ka përfshirë edhe lagjen tonë,

por kurrë asgjë nuk është bërë në atë drejtim, edhe e treta, e kam propozuar që edhe spitali të hapet te unaza.

Arbër Sadiku, për punën e nxehtë, është e vërtetë që ekziston projekti me Bankën Gjermane për Zhvillim, që përmes paneleve solarë me u lidhë tri lagjet kryesore të Prishtinës me nxehtë qendrore. Ai projekt është nënshkruar para 1 muaji ose 1 muaj e gjysmë dhe është në zhvillim e sipër. Ne jemi takuar disa herë me drejtorin e Planifikimit me komunën e Obiliqit, për shkak se parcelat në të cilat shtrihet. Ky park solar është në komunën e Obiliqit, edhe në gjithë angazhimin tonë e kemi bërë që me i gjetur të gjitha format e kompensimit, që me na lejuar neve që me zhvilluar këtë projekt. Kjo marrëveshje është kryer, janë nënshkruar krejt kontratat, është në proces e sipër, tash do të filloj zbatimin. Ndërsa te pjesa e legalizimit, shumicën e problemeve ne që i kemi në legalizim, jo veç te lagja juaj por edhe në lagjet tjera lidhen pikërisht me pronësinë. Ligji për legalizim nuk lejon me lëshuar certifikatë të pronës dikujt që ka ndërtesë në një tokë që e ka të paqartë pronësinë. Rrigjenerimi i lagjes është e vetmja mënyrë për me e bërë zgjidhjen e këtyre problemeve që janë në lagjen tuaj, e që janë të ndryshme problemet e pronësisë këtu, ju e dini këtë. dhe e vetmja mënyrë është nëse këto probleme i shohim dhe i trajtojmë ne plan më të gjerë .

Fatmir Beqiri, banor i lagjes, theksoi se në rrugën tonë nuk mundesh me kaluar prej erës se kanalizimit, kundërmon shumë rënd, ky problem nuk është vetëm tani po është kaherë, edhe askush nuk është marrë me këtë çështje. Nëse nuk më besoni ejani me mua dhe e shihni edhe vetë.

Alban Zogaj theksoi se jemi duke u marrë edhe me pjesën e kanalizimit dhe te ujit, besa edhe me ndarjen e ujërave atmosferike dhe atyre fekale. Drejtorja e Investimeve Kapitale, drejtori Krenar Xhaferi është duke u marrë me probleme, andaj ju lutem adresoni këto kërkesa, na dërgoni me e-mail ose me shkrim edhe na tregoni saktësisht për ku është problemi që ne me i marrë masat menjëherë.

Fahri Hoxha, banor i lagjes, u shpreh se në lagjen tonë mungon shumëçka, kemi mungesë të fushave sportive, i kemi vetëm ato që janë nëpër shkollë, kemi mungesë të hapësirave të gjelbra, mungojnë qendrat për të moshuar. Është folur diçka për një Qendër sportive në Bërnice, por ende asgjë.

Arber Sadiki bëri të ditur se është duke u zhvillu plani për Qendrën sportive në Bërnice, jemi në diskutim me të njëjtën kompani që do ta zhvillojë projektin kryesor. Fondet janë ndarë për këtë projekt, janë vetëm punët teknike që kanë mbetur me u kryer, punët me të cilat ne çdo ditë merremi. Projekti është, një projekt gjigand, që kërkon kohë, dhe ajo çka është e sigurt, është se është duke shkuar në rrugën e duhur për të cilën edhe ka premtuar kryetari. Është analizuar në kuptimin e termave urban, ku atje planifikohet me kaluar unaza. Është edhe pjesa e pishinës, d.m.th. gjithë ajo pjesë do të zhvillohet për sporte dhe rekreativitet. Për atë që thate që keni vetëm salla nëpër shkollë, desha të ju jap një informacion nëpër botë, edhe ne po duam atë praktikë me e zhvilluar edhe këtu, ku sallat e shkollave shfrytëzohen, të projektohen me hyrje të veçanta, me një pjesë të garderobave të veçanta, për të mundur me u përdorur edhe prej komunitetit. Ne jemi duke punuar edhe me departamente tjera, edhe me drejtor të shkollave, me të gjithë ata që menaxhojnë me këto asete, me kuptuar se këto janë pjesë e komunitetit dhe duhet me u shfrytëzuar prej komunitetit.

Isa Ilazi theksoi se jemi 26 pronarë në një parcelë, ne nuk mundemi as me e shitur, as me e përkthyer, as me ndërtuar. Në planin e mëhershëm Unaza - rruga kalon nga prona jonë.

Arbër Sadiki u shpreh se probleme të kësaj natyre kemi shumë, e kam fjalën për problemin me pjesën e gjelbërimit që as nuk shpronësohet, as nuk jepet leja e ndërtimit, edhe ti në një farë mënyre je peng. Kjo është ajo çka ne po mundohemi me e bërë, që në hartat zonale që do t'i zhvillojmë tash e tutje, me e parapa saktë, që pjesët që merren për gjelbërim me e pa mundësinë që brenda atij blloku ku mundet me u bërë kompensimi me të njëjtin koeficient ndërtimi. Ne po mundohemi me i kalkuluar në atë mënyrë që këto hapësira që janë për publik mos me i tejkaluar 20% të tërësisë së bllokut, që mandej zgjidhja mos me u bërë parcialë, por me gjithë bllokun, dhe të gjithë me e pasur të njëjtin benefit prej kësaj.

Isa Ilazi tha se përballë parcelës sonë është pjesa që është e Komunës, pse nuk e kane bërë në plan që rruga me kaluar andej po nga prona jonë.

Arber Sadiki u shpreh se ne këtu nuk mundemi me iu dhënë përgjigje konkrete për raste konkrete. Këtu jemi me ju tregu parimet se qysh kanë me u trajtuar këto çështje, të jesh i sigurt që edhe ajo pjesa e juaj ka me u trajtuar me krejt mundësitë. Në këto raste, si rastin e juaj që jeni shume pronare, në javët në vazhdim ulemi dhe e diskutojmë, e caktojmë një takim edhe e shohim se si mundemi me e trajtuar.

Shaip Hajrizi, banor i lagjes që 70 vjet, tha faleminderit shumë për iniciativën për me ardhur në vizitë në lagjen tone. Këtu kemi shumë probleme, kemi mungesë të shkollave, të parqeve, çerdheve, kemi mungesë të linjave të autobusëve, që duhet me u shtuar, kemi problem me kanalizim, me rrugë. Këto probleme i kemi paraqitur edhe te kryetari gjatë fushatës dhe kemi besim të madh që do të realizohen. Unë i kam 2 çështje që kisha me i prekur, përveç këtyre që i ceka më herët. Kur do të fillojë procesi i legalizimit dhe sa do të zgjasë, sepse pa u kryer ky proces Plani nuk mund të realizohet, edhe a e ka paraparë Komuna nxehjen për lagjen “Kodra e Trimave”.

Arbër Sadiki për panelet solar e thash, që një prej lagjeve që është e paraparë është edhe lagja juaj, ndërsa sa i përket procesit, ai ka filluar nga sot. Ky diskutim që po e bëjmë sot është pjesë e këtij procesi. Ne po përpiqemi që përmes këtij transformimi urbanistik me i zgjidhur edhe problemet e pronave. Rigjenerimi e ka këtë qëllim, përmes planifikimit me i zgjidhur edhe probleme tjera. Ne duhet me hy lagje për lagje, me e pa se cila është përqindja e pronave që janë me probleme, cilat janë prona pa probleme, edhe me pa propozimi konkret cili kish me qenë, që me i zgjidhur këto probleme përmes një rigjenerimi urban, ndryshe nuk ka zgjidhje.

Burim Avdiu banor i lagjes, pyeti se “Kodra e Trimave 1” a është në plan zhvillimor.

Mimoza Sylejmani tha se një Plan rregullues ekziston, por Harta zonale e përfshin gjithë qytetin, s’ka me pasur më ndarje. Kur bëhet planifikimi, Harta zonale ka me qenë e tërësishme, e a rritet koeficienti a jo unë nuk mundem tani me të dhënë përgjigje, se është një grup i madh që është duke punuar për hartimin e këtij projekti, e kur të vijmë në atë pikë ne prapë kemi me pasur takime e diskutime. Për momentin po dua si informatë me ua dhanë, se Harta zonale e përfshin gjithë Prishtinën, po ashtu edhe fshatrat, siç e ka thënë edhe kryetari në fushatë, që do të bëhet ndërlidhja e zonës urbane me zonën rurale. Plane rregulluese të hollësishme ka me pasur vetëm në raste specifike, kur duam me e trajtuar një lagje.

Vedat Havolli propozoi që me pasur kujdes me koeficientin në lagjen tonë, që mos me shkatërruar si pjesët tjera të Prishtinës. Ju e dini se Kodrën e Trimave e keni lënë shumë mbrapa. Këtu ka nevojë për

gjelbërim, ka nevojë për shkolla, për fusha sportive etj. Nuk pajtohem me atë që u tha më herët me u përdorur sallat e shkollave, kur mundemi me i pasur sallat tona.

Fahrije Beha, banore e lagjes, theksoi se kemi problem me kanalizim, sa herë që bie shi ka vërshime dhe krejt uji i kanalizimit hyn nëpër shtëpi. Ky problem është i kahershëm dhe ende nuk është zgjidhur.

Ilirik Musliu bëri të ditur se janë duke punuar në mënyrë paralele, në të njëjtën kohë për rigjenerimin e lagjes suaj, Planit zhvillimor dhe Hartës zonale, por normal që këto problemet e përditshmërisë nuk mundemi me i neglizhuar, pjesa e kanalizimit është çështje shumë urgjente, që duhet me u intervenuar menjëherë, dhe ne e marrim përsipër kërkesën tënde që sot.

Elhame Krasniqi tha se nuk jam banore e lagjes, por e kam një pronë te rruga “Koto Hoxha”. Më herët nuk ka qenë e urbanizuar, por tani është, andaj desha të ju pyes se a është në plan ajo pjesë a jo.

Florim Krasniqi i propozoi parafolëses që ajo të shkojë në Zyrën për planifikim në objektin e ri të Komunës, të martën dhe të enjten, ku janë takimet me palë, edhe e shohim saktësisht për ku bëhet fjalë.

Zenel Veliu, banor i lagjes, rr. “27 Nëntori”, tha se ne kemi shumë telashe këtu, rrugën e kemi të paasfaltuar, por problemin kryesor e kemi çështjen e pronësisë. Unë jetoj që 50 vjet këtu edhe ende se kam legalizuar pronën time.

Emine Haxholli, fillimisht një ankesë për organizimin. Ne mbrapa asgjë nuk kemi dëgjuar shkakun i zërimit. Para se të filloni me Planin, ju kisha lutur që ta zgjidhni problemin e pronave. Ne kemi probleme shumë me ujin dhe kanalizimin. Në rrugën tone shiu i parë që bie na merr uji, edhe kurrë as edhe njëherë nuk është bërë asnjë kompensim. Tatimi në pronë duhet të ndahet, nuk mund të paguajmë njëjtë si neve që na merr uji, si ai p.sh. te Xhamia e Llapit që nuk e ka atë problem. Ka shumë kërkesa për asfaltimin e rrugëve, për lidhjen e fshatrave të komunës së Prishtinës me transport, por me prioritet duhet të merret çështja e kanalizimit.

Arbër Sadiki theksoi se vazhdimisht po përmendet çështja e pronave, por ne gjithë angazhimin tonë jemi duke e bërë që me u zgjidhur problemet me pronat përmes mekanizmave të cilët janë në dorën tonë. Nëse mendoni që problemet pronësore mundeni me i zgjidhur në kuptimin e titullarit të pronës, atë ndarje Komuna nuk e ka, nëse ia jep ligji, për atë ne e kemi pa si mundësi që përmes këtyre mekanizmave që lidhen me planifikimin, me e bërë një zgjidhje gjithëpërfshirëse. Ne jemi këtu për të ju thënë atë çka është e mundshme edhe çka është në dorën e Komunës së Prishtinës.

Jetullah Beqiri, banor i lagjes, theksoi se ne sot po i parashtrojmë kërkesat tona, që shpresojmë ti realizoni për 4 vjet, ose nëse nuk i realizoni do të na keni kundërshtarin me të madh. Unë vij nga komuniteti artistik. U paraqitën shumica e shqetësimeve tona, por ne kemi mungesë të shkollave, të çerdheve, nuk kemi as edhe një qendër kulturore në lagjen tone. “Kodra e Trimave” i ka 70 mijë banorë. Një Qendër kulturore është nisur dhe është ndërprerë puna. Ata që i ndërprejnë këto projekte duhet paditur në gjyq. Për 20 vjet janë ndërruar kryetar e qeveri e mos me qenë në gjendje 2 lopata beton me i qitur e me e ndreq një çerdhe për fëmijë, ata njerëz kanë bërë krim. Prishtina as edhe një vend nuk e ka për me e bërë aktivitetin e vet kulturor. Është mjerim elementaret mos me i pasur, është momenti i fundit tani, te ju i kemi shpresat, për atë edhe votën ju kemi dhanë.

Arber Sadiki u shpreh i pajtimit me kërkesat tuaja, dhe absolutisht jam dakord me ato që i përmendët, por ne jemi me një pozicion që po luftojmë se qysh munden me u bërë krejt këto përmes rrugëve ligjore. Po ju jap një informatë shumë bazike. As edhe një fond as prej ministrive tona, as prej donacioneve nuk jepet pa qenë të zgjidhura problemet juridiko-pronësore. Ne vazhdimisht nuk mundemi me i realizuar edhe ato pak mjete që herë pas here i kemi për shkak te problemeve të lokacioneve. Rrugat për të pasur investime është me i zgjidhur problemet edhe me pronat. E përmende Qendrën kulturore, nuk dua me i

dhënë kredi vetes, por ajo Qendër kulturore është nisur prej meje, bashkë me studentët e mi e kemi analizuar dhe propozuar edhe e kemi pasur përkrahjen e qeverisjes së atëhershme, që nëse bëhet investimi i parë kulturor, bashkë me universitetin ku punoj unë, do të bëhet në Kodrën e Trimave. Atë projekt e kemi projektuar pa pagesë atë projekt, me shumë dëshirë e me shumë vullnet për ta përfunduar. Ka shkuar në prokurim publik sipas procedurave edhe kanë ardhur oferta me gjysmën e çmimit të cilin ne e kemi planifikuar. Është nisur puna edhe është ndërprerë për shkak të ofertës me çmimin më të ulët. Rrugët për me u zgjidhur problemet, janë të precizuara me ligje, edhe ne po mundohemi me e gjetur rrugën që me punuar me ato kompetenca të cilat ne i kemi në dorë.

Islam Islami paraqiti një kërkesë. Është një taksë në transaksion që paguhet vetëm në Prishtinë, në asnjë qytet tjetër të Kosovës nuk paguhet, pse vetëm ne jemi ngarkuar me këtë taksë.

Alban Zogaj theksoi se jemi marrë me këtë temë dhe ka qenë edhe propozim në Kuvendin komunal që disa herë me radhë, që të hiqet taksa, edhe në parim jemi dakord që të hiqet, por vetëm jemi duke bërë disa analiza financiare që me e pa çfarë efekti jep heqja e saj. Pas përfundimit të këtyre analizave besoj që do të vijmë në përfundim që me e hequr.

Besim Gërguri parashtroi një pyetje, duke thënë se sa zgjat afati i legalizimit për aplikim.

Arbër Sadiki për punën e legalizimit, 4 shtatori është afati i fundit për aplikim, kështu që unë ju kisha thënë aplikoni. Gjatë procedurës ekziston mundësia që në qoftë se ti ndryshon diçka në pronësi, ajo mund të plotësohet pastaj.

Bedri Krasniqi tha se 12 vjet e ka qeverisur LDK-ja, por as edhe një investim nuk e ka bërë në lagjen “Kodra e Trimave”, ka uzurpime, ku ka qenë Komuna, pse nuk ka ndërmarr asgjë. Ne jemi në gjendje shumë të vështirë, as nuk kemi rrugë, as kanalizime, as çerdhe, as parqe, asnjë problem që ballafaqohemi ne, nuk është zgjidhur. Duhet marrë masa.

Mehedin Dini, banor i lagjes, rr. “Çeta e Llapit”, është rrugë gati 20 metra, është krejtësisht baltë, andaj ju kisha lutur që ajo rrugë të rregullohet. Edhe kabllot e rrymës që janë paraqesin shumë rrezik aty, ju kisha lutur që të ndërmerrni diçka se që sa vjet asgjë.

Ismet Beqiri, banor i lagjes (ish-kryetar i Komunës), iu shprehu mirëseardhje kryetarit të Komunës dhe stafit të tij. Ai theksoi se ne këtu jemi banoret e kësaj lagje, dikush jeton këtu që 50 vjet, dikush edhe më shumë. Lagja jonë ka kaluar nëpër disa faza. Faza e pasluftës ka qenë fazë emergjente. Pas luftës në Kodrën e Trimave janë së paku 70 rrugë të shtruara. Edhe unë kam qene kryetar, ka qene Isa, ka qenë Shpendi, tani është Përparimi, për ne është me rëndësi me i realizuar projektet. Faza emergjente ka kaluar në Kodrën e Trimave. Edhe në kohën e ish-kryetarit, Isës, është bërë shkolla e re, është bërë Qendra e Mjekësisë Familjare, është bërë Qendra për Punë Sociale. Ajo çka ju kisha lutur juve është që krejt këto projekte që i keni në plan t’i realizoni, ne jemi lagje që kemi sakrifikuar shumë, kemi nevojë për gjelbërim, qendra rekreative, për një qendër kulturore, kemi nevojë për çerdhe. Ju kisha lutur që

koeficienti për lagjen tonë të jetë më i lartë, sepse është absurde që lagjja jone me pasur një koeficient të ulët. Unë e di që zoti Rama është arkitekt, ka projekte, nuk ka fituar rastësisht, por kjo lagje e meriton me u trajtuar me dinjitet dhe është koha e fundit për ta marrë atë që e meriton.

Elmi Dili, banor i lagjes, rr. “27 Nëntori”, theksoi se ne jemi gati 60 shtëpi, ujë nuk kemi, kanalizimin e kemi nëpër oborre, para një jave u bllokua por askush nuk është marr me këtë çështje.

Zahir Hajdini, banor i lagjes, u shpreh se ardhja juaj këtu është me vonesë, mënyra si keni ardhur është gabim, nuk ka Plan zhvillimor as zgjidhje të problemeve të pronës. Për kryetar e kam një pyetje. Kodra e Trimave me 1500 vota difference, pse nuk ka përfaqësues ne ndërmarrjet publike komunale.

Alban Zogaj u shpreh se me bindje të plotë po ju them që “Kodra e Trimave” është në fokus të kryetarit Rama, dhe me vetë faktin që ne jemi këtu me juve, që po bashkëbisedojmë, po marrim pyetje, ankesa e ide, tregon shumë, edhe atë menjëherë pas 4 muajve që e kemi marrë mandatin. E dyta, për pyetjen e përfaqësimit në ndërmarrje publike, edhe pse është temë tjetër, dua të përgjigjem. Në ndërmarrje publike përfaqësohen asamblastët e Kuvendit komunal. Në 10 NP ne i kemi dërguar aksionarët tanë që janë aksionarë të Kuvendit komunal, edhe këtu po shoh asamblastë që janë të përfaqësuar në NP, p.sh. Donjeta është këtu, Dasmori. Drejtorët zgjidhen me konkurse publike, të gjitha do ta marrin kohen e vet.

Fadil Aliu, banor i lagjes. Ai tha se unë jam Fadil Aliu, i përkas kësaj lagje dhe ballafaqohem me të njëjtat probleme sikur secili prej jush. Është e vërtetë që kryetari Rama gjatë fushatës e ka pasur moton “Prishtina për të gjithë”, nuk është që vetëm “Kodra e Trimave” meriton me i dhënë atë respektin që e

meriton, por me të vërtetë kryetari Rama e ka atë qasje që me e bërë një barazi mes të gjitha lagjeve, prandaj e kam një sugjerim për juve sot, ekipi është këtu, andaj ju kisha lutur që me e shfrytëzuar ekipin sot, me propozimet konkrete të cilat na prekin, mos të dalim jashtë temave se kemi me pasur kohë edhe ato me i prekur, e në bazë të kërkesave, ankesave e ideve me zhvilluar projektin për të cilin janë këtu.

Arbër Sadiki u ndërlidh me diskutimin e parafolësit. Ai tha se ne sot këtu jemi për me bashkëbiseduar për problemet që lidhen me PZHK-në dhe me Hartën zonale, sepse ato të dhëna teknike neve na duhen që me i pasur këto plane më të prekshme dhe më të realizueshme.

Mustafë Gashi, banor i lagjes, pyeti se a do të ketë ndërtim të larta në lagjen tonë.

Shaban Krasniqi, banor i lagjes, tha se tash e 60 vjet jam banor i kësaj lagje, andaj desha të dijë se a do të ketë legalizim të pronave për ata që veç i kane ndërtuar shtëpitë ne ato prona.

Arbër Sadiki tha se arsyeja pse jemi ne sot këtu është pikërisht kjo temë.

Kryetari, Përparim Rama, iu kërkoj falje të pranishmëve që nuk pati mundësi të jetë që nga fillimi i këtij diskutimi publik. Ai tha se e kemi nënshkruar një numër të madh të kontratave për zhvillimin e Komunës së Prishtinës, zhvillimin e gjelbër. Besoj se jeni informuar nga ekipi. Ideja e takimit me qytetarë është pikërisht për të punuar së bashku për transformimin e të gjitha zonave të Prishtinës ku jetojmë. Kodrën e Trimave e kemi pasur dhe e kemi prioritet, për arsye të problemeve të ndryshme. Ndër problemet kyçe është edhe aspekti i pronësisë. Më shumë se 70% e kanë këtë problem. Ne kemi ardhur me biseduar me ju dhe me ju treguar se ky proces që e kemi filluar nuk përfundon këtu, ky është vetëm fillimi, dhe jeni të mirëseardhur me qenë pjesë e këtij procesi edhe në të ardhmen, nëpërmjet fuqizimit të bashkësive lokale, tash e kemi afuar Komunën e Prishtinës më afër qytetarëve. Përmes Planit zhvillimor dhe hartave zonale vetëm kemi hy ne një proces të madh, por gjatë kësaj paralel ne duhet të zgjidhim edhe

një numër të madh të problemeve të vogla. Kemi biseduar edhe për vendkalime, edhe për rethrotullime, për të gjitha këto gjëra të vogla. Fondet i kemi, por ne duam me i zgjidhur bashkë me komunitetin, kush më mirë se ju e din se çfarë i nevojitet Kodrës së Trimave. Jemi duke punuar edhe me institucione ndërkombëtare, me Bankën Botërore, dhe me ekipet tona përbrenda Komunës, por edhe me specialistë nga jashtë për me na ndihmuar gjatë këtij procesi, kështu që ju falënderoj shumë që jeni këtu sot me ne.

Mustafë Gashi, banor i lagjes, pyeti se a ka me pasur ndërtime të larta në lagjen tonë.

Kryetari theksoi se për të krijuar hapësira të gjelbra, shkolla, çerdhe duhet të ngrihemi lart që të kemi këto hapësira që na duhen.

Shaban Krasniqi, banor i lagjes, pyeti se a ka me pasur legalizim të pronave për ata që veç i kanë ndërtuar shtëpitë në ato prona.

Kryeatri bëri të ditur se nëpërmes rigjenerimit urban ne tani jemi duke e zgjidhur edhe problemin e pronësisë. P.sh. nëse ju e keni ndërtuar shtëpinë që 40, 50 apo 60 vjet në pronë komunale, atëherë procesi duhet me qenë që ajo pronë me u legalizuar përmes rigjenerimit, pra hiqet, zhvillohet, por në vendin ku je të ri është e jotja. Pra është ideja jo me krijuar probleme, por me zgjidhur probleme.

Arian Mustafa, banor i lagjes, magjistër i shkencave, u shpreh se po e shoh që e keni marrë këtë punë me shumë seriozitet. Për t'i zgjidhur problemet e kësaj lagjeje, unë vullnetarisht ju ofroj idetë, këshillat e sugjerimet e mia. Ai pyeti se a e keni caktuar zonën ku do të filloni me projektin.

Kryetari theksoi se jemi në proces të punës.

Arian Mustafa tha se unë të gjitha i dëgjova me vëmendje çka u tha deri tani. Me përpara kjo pjese ka qenë më e zhvilluar ekonomikisht, ka pas dyqane, ka pas biznese e tani për shkak të shumë kushteve, pjesa më e madhe e bizneseve kanë ndërruar lokacion, p.sh. në Fushë-Kosovë. Mendoj se kishte qenë mirë me u kthyer Stacioni i Autobusëve si ka qenë, Tregu i automjeteve, me pasur më shume biznese.

Kryetari theksoi se në çdo proces të rigjenerimit bazë është krijimi i vlerave shoqërore, krijimi i hapësirave të gjelbra, rekreative, çerdhe, shkolla, parkingje, qendra mjekësore, jemi duke planifikuar në Bernicë të Poshtme, në shërbim të Kodrës së Trimave, se është shumë afër, Kampusin e Sporteve me të gjitha mundësitë për zhvillimet sportive, zonë komerciale gjithashtu, me këto elemente të rigjenerimit ne po mundohemi me e ndihmuar Kodrën e Trimave, se procesi i rigjenerimit është shume i gjatë. Ideja është që me bërë zgjidhje paralele të nevojave bashkë me ju, së bashku ta ndërtojmë.

Skënder Halimi, banor i lagjes, theksoi se kësaj lagje i mungon shumëçka, u cekën deri tash gati të gjitha, por kisha pasur dëshirë që në Planin e ardhshëm lagja jonë të mos bëhet si disa shembuj të këqij të ndërtimit, kemi modele mjaft për të keq. Po e them këtë edhe si gjeograf që jam, jo vetëm si banor i

lagjes. Pyetje kisha se si do të bëhet kompensimi.

Kryetari u shpreh se e kam përmendur shumë aspektin e vlerës shoqërore. Çka d.m.th. vlerë shoqërore? Nëse ne jetojmë në zona ku kemi qasje në hapësira të gjelbra, ndihemi të sigurt me punuar aty afër, ka shkolla, ka qendra për të moshuar, kemi zona sportive, kemi ku me parku makinën, të gjitha këto kalkulohe si një zonë e mirë për me jetuar, mundësia për të lëvizur prej kësaj zone në zonën tjetër lehtësisht. Të gjitha këto janë zonë e zhvilluar urbane. Secila zonë është unike në veti, secila prej tyre

paraqet diçka të veçantë në vete, ne duhet me e njohur e hulumtuar çdo detaj që e karakterizon secilën zonë në veçanti. Por te ju e kemi një raste shumë të mirë që me i qitur në pah karakteristikat e Kodrës së Trimave përmes regjenerimit.

..... (banor i lagjes), Në lagjen tonë ka shumë probleme, por kisha pasur dëshirë që kjo lagje me u trajtuar si tërësi, me krejt problemet e veta që i ka. Siç u tha edhe më herët, këtu ka pasur edhe biznese të shumta, por shkak i kushteve është dashtë me ndërruar lokacion, që është e dëmshme edhe për Komunën e Prishtinës, por në radhë të parë për neve që jetojmë këtu.

Kryetari theksoi se Plani zhvillimor komunal shihet si tërësi, edhe ashtu dizajnohet. E dimë që Prishtina i ka 350 mijë banorë, ky numër pritet të rritet, e dimë që kemi bukuri natyrore të malësisë së Gollakut e të Llapit, e ato janë si zhvillim i së ardhmes, për të ndaluar edhe migrimin. Kemi shkolla që i kemi ndërtuar e që janë thatë, kemi potencial të madh jo vetëm në zonën urbane, këtë balancë e bëjmë duke analizuar krejt qytetin, nevojat e qytetareve edhe duke i vënë në pah elementet unike të zonës.

..... (banor i lagjes), po më intereson të di se si do të bëhet kompensimi, a me metër katrorë, se ka njeri që e ka ndërtuar shtëpinë p.sh. edhe e ka 200 ose 300 metra katrorë, tash a llogaritet edhe shtëpia, shpenzimet e shtëpisë, apo vetëm sa arë ka prona.

Kryetari bëri të ditur se ka probleme të shumta edhe të ndryshme, të cilat duhet me i zgjidhur gjatë procesit, duhet me i hy punës për me e pa qysh mundemi me i zgjidhur në mënyrën më të drejtë të mundshme. Po e marr shembull, në Mal të Zi, ke zonë që e ka çmimin nga 10 mijë euro për metrin katror, edhe ke zonë që është 200 metra më larg dhe është 1000 euro metri katror. Tash çka pyesim, çka e ka ngritur vlerën e atij metri katror, funksionet që i ofron ajo zone, mënyra e jetës, mundësitë e ndryshme e ngrënë vlerën. Nuk është krejt te metri katror. Në shumë zona metri katror e mbyt çmimin, si ne rrugën “B” p.sh. pjesën shtesë çka e ka ndërtuar e ka devaluuar krejt zonën. Nuk duhet me e shikuar me metër katror, por duhet me e shikuar çfarë vlere po ndërton. Do ta shihni kur të bëhet zhvillimi, nëse ne arrijmë përmes rigjenerimit urban me e ngritur vlerën e secilës shtëpi, secilës familje ne jemi fitues, edhe ai është synimi, kur e ngrënë nivelin e jetesës, ajo automatikisht e ngrit vlerën e zonës.

Rrahman Hoti, banor i lagjes, tha se prej të gjitha lagjeve, lagjja jonë është më e diskriminuara, lagjja jonë veç e ka historinë e vet. Unë kërkoj nga ju që me ia kthyer dinjitetin kësaj zone: 1) Të klasifikohen zonat edhe sipas zonave të rritet koeficienti, 2) pronat e kontestuar t’u jepni mundësinë që të kalojnë në pronësi të banorëve që i shfrytëzojnë që sa vite, edhe 3) Të ndërtohet një Qendër e sporteve luftarake. “Kodra e Trimave” i ka dhënë shumë sportit luftarak dhe mendojmë se e meritojmë një qendër të tillë.

Elfije Thaqi, banore e lagjes, tha se në lagjen tonë ka mungesë të çerdheve, rrugët janë tmerr, nuk kemi park, mungon transporti që na lidh me qendrën, por kryesorja është që të legalizohen pronat.

Qamil Hajdini, i tha kryetarit se e kam një kërkesë, që me i dhënë prioritet Kodrës së Trimave, ngufatja është këtu në këtë zonë si për ndërtim, si për gjelbërim, se është hapësirë shumë e madhe.

Kryetari bëri të ditur se procesi i rigjenerimit të kryeqytetit është prioritet, në rigjenerim është Kodra e Trimave, Kolovica dhe Prishtina e Vjetër, këto zona janë prioritet. Fillojmë nga Kodra e Trimave, se në këto zona është densiteti i madh e urbanizmi katastrofë, ky është qëllimi i regjenerimit.

Kryeatri tha se edhe për zonjën, zgjidhjen veç e përmenda më herët, është krejt ky procesi i regjenerimit, në të cilin jemi duke punuar, ku bëhet edhe legalizimi i pronave. Ti e merr p.sh. në ndërtim të ri me letra, je pronare, edhe krijimi i hapësirave tjera krejt kjo është qëllimi me i krijuar ato që mungojnë në këtë lagje, si pjesë e kësaj bëhet edhe zhvillimi, edhe ndërlidhja me zonat e tjera.

Ismet Beqiri, falënderoi kryetarin për pranie e tij, duke thënë se ne shpresat i kemi te ti, edhe po shpresojmë që ke me e trajtuar këtë lagje në mënyrën më të mirë të mundshme, se me të vërtetë është lagje e veçantë, kështu që edhe nëse vonohemi pak, më mirë një lagje me plan, se një lagje pa plan. Kjo lagje e meriton me u trajtuar me dinjitet, kjo lagje i ka dhënë shumë këtij vendi. Unë besoj që punën që e keni filluar do ta realizoni në mënyrën më të mirë, edhe koeficientin me e ngritur do të krijoni mundësi më shumë për këtë lagje.

Kryetari i falënderoi të pranishmit për kontributin që dhanë.

“Kodra e Trimave”, Prishtinë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 31.05.2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	ARMEND VITIJA		
2	Fikret Haxho		
3	Azem Xhimagi		
4	Komilon Balligaj		
5	Helmuti Begdini		
6	AVDUL BEGOLLI		
7	SKENDER HALIMI		
8	Vesa Vitijs		
9	ZEKIR BILALU		
10	Abdyli Kaciri		
11	Mehmedin Vitijs		
12	SHKURTE EJUPI		
13	Poland Jorg		
14	KASTRIT KOSUMI		
15	Egon Pacali		
16	SHKOL KRASNICI		
17	Arjan Mustafa		
18	BEKIM GJOKO		
19	Jamel Began		
20	PRISTEN KASO		
21	ZAHIR JETULLAH		
22	MURAT DUSHUTLOVICI		
23	Goran Itheli		
24	Geneta Draguna		
25	Shedur Begolli		
26	Krahman Vehiu		
27	Ahmet Probraca		
28	Arjan Mogoli		
29	Alban Beg		
30	Bedri Krasni		
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 31.05.2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	Hasp Hajrizi		
2	MUSTAF SADIRU		
3	Qajim Akemi		
4	Tejmur Bajrami		
5	Edhe Bëgjica		
6	ABEDIN ISHAICI		
7	FAHRI HOXHA		
8	XHAPEN ÇAUÇOLLO		
9	FERRI STREJMAVI		
10	SHPEHO BILALLI		
11	NEZHMETI KASNIERI		
12	ALI GRACA		
13	ISA JLAZI		
14	ALI BRASHORI		
15	Donat HAZI		
16	ARMIR GECI		
17	Emine Harholli		
18	Qajim Shajkhi		
19	ILIR BERISHA		
20	AFRIDA ZENELI		
21	Qajim R. Bajraktari		
22	AVNI MURTEZI		
23	FLAMUR ZEKA		
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 31.05.2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	Ariana Samragi		
2	Elmiedina Beka		
3	Arman Haxho		
4	Elhame Nila		
5	Arjan Bulliqi		
6	Kadi STAFUCCI		
7	JOSE VITAJA		
8	Bayrak Uthja		
9	ZENEL VELIU		
10	Anda Salihu		
11	Shaban Krasniqi		
12	DASAR OVEKISKI		
13	MUSTAFA GASHI		
14	NERMINI HADRIZI		
15	Edmond Haxhi		
16	BAHİR MURTERI		
17	Enxhin / Nermin		
18	ISLAMI ISLAMI		
19	Donat Krasnolli		
20	SHADAN GASHI		
21	Asllan Begim		
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 31.05.2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	FEIM SALIHU		
2	DIBRAN REXHA		
3	Uroshan Vllasa		
4			
5			
6			
7	Shahin Aliu		
8			
9	Muhomet RAMU		
10	Shaban Vuku		
11	Vigdan Vitija		
12	Adrian Risti		
13			
14	Isak Rendi		
15	Bedri Kosumi		
16	Mehmet Veliu		
17			
18	Musar Dushi		
19	Leviz Haxhiu		
20			
21	Hafiz Zogari		
22	BURIN AUDINO		
23	Satmir Beyku		
24	Aniamita Xhasmija		
25	ILIR MURRI		
26	SHAHIN BAZA		
27	VAHID KELLARI		
28	VITOST KRANIRI		
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			